



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

Procesverbal nga konsultimi publik për plotësim-ndryshimin e Rregullores së Taksës Komunale

Me datën 19 Qershor, është mbajtur konsultimi publik për plotësim-ndryshimin e Rregullores së Taksës Komunale.

Njoftimi për mbajtjen e takimit publik është publikuar me 29.05.2026 në uebfaqe të komunës në vegzën:

<https://ferizaj.rks-gov.net/ep-content/uploads/2026/06/NJoftim-Shqip.pdf>

Në këtë konsultim publik ka marrë pjesë drejtorja e Financave Sebahate Ajeti-Sadiku, drejtori i Arsimit Afrim Llabjani, drejtori i Shërbimeve Publike Alberton Sahiti si dhe drejtori i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Dr. Kemjal Emmini.

Me datën 19 qershor duke filluar nga ora 10:00 në sallën e Kuvendit të Komunës, është mbajtur konsultimi publik për plotësim-ndryshimin e Rregullores së Taksës Komunale.

Në këtë takim publik kanë marrë pjesë 10 qytetarë 2 femra dhe 7 meshkuj.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

Gjatë hapjes së konsultimit publik, drejtoresha e Financave, Sebahate Ajeti-Sadiku, theksoi se plotësim-ndryshimi i kësaj rregulloreje ka qenë i domosdoshëm, duke pasur parasysh se ajo është miratuar vite më parë dhe kërkon përshtatje me nevojat dhe rrethanat aktuale. Sipas saj, ndryshimet e propozuara pritet të përfshijnë, ndër të tjera, edhe Drejtorinë e Arsimit dhe Drejtorinë e Urbanizmit.

Një nga propozimet e paraqitura është edhe rritja e tarifave për kopshtet e fëmijëve.

Gjatë takimit u prezantuan ndryshimet e propozuara, ndërsa qytetarët, bizneset dhe grupet e interesit u ftuan të kontribuojnë me sugjerimet dhe vërejtjet e tyre në procesin e hartimit të dokumentit përfundimtar.

Ajo shprehu gjithashtu pakënaqësinë për mungesën e interesimit të qytetarëve për të marrë pjesë në këtë konsultim publik.

Rregullorja për plotësim-ndryshim do të mbetet në konsultim publik deri më 10 korrik, ndërsa të gjithë të interesuarit mund të paraqesin propozimet dhe komentet e tyre përmes adresave zyrtare elektronike të Komunës së Ferizajt.

Qytetarët mund t'i dërgojnë propozimet e tyre në adresat elektronike:

- info.ferizaj@rks-gov.net
- sebahate.sadiku@rks-gov.net
- arber.bytyqi@rks-gov.net
- afirm.llabjani@rks-gov.net



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT

KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA

MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002

E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net

Adresa: Rr."Dëshmorët e Kombit" p.n.

Komuna e Ferizajt u bën thirrje qytetarëve që të marrin pjesë aktive në këtë proces, me qëllim që rregullorja e re të reflektojë sa më mirë nevojat dhe interesat e komunitetit.

Në këtë konsultim publik Alidon Alidema nga barnatorja Riga, ka pasur kërkesë që çmimi i reklamave në pronën e tyre private të mos paguhet, për shkak se shfrytëzohet hapësira e tyre publike dhe jo e komunës.

Pyetje të tjera gjatë këtij konsultimi nuk ka pasur, ndërsa konsultimi publik u mbyll në orën 10:50.

Procesmbajtëse

Shyhrete Topalli-Rexhepi